

Datë: e martë, 2022-07-05

Ora 14:53
Nr. 5/727 Prot.
Dosja Nr. 727

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit, me adresë në:
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e
Ushtarakëve, Tiranë;

Për dijani Debitorit: Shoqërisë "REMI TRANS" Sh.p.k., me NIPT L61308061D,
dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan,
Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues
Ligjor **Z. Ardit Palushi**;

Për dijani Kreditorit: Shoqëria "IVAN OIL" Sh.a., shoqëri tregtare e regjistruar
pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT
L81920001S dhe adresë në: Bulevardi "Dëshmorët e
Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr. 1, Kati 13, Tiranë,
përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor **Z. Eqerem Hoxhaj**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë zyrës përmbarimore private ARB
pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. 727, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit
Nr. 9284 Regj. Them., datë 15.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se më datë 17.06.2022 është depozituar pranë ARB kërkesa e kreditorit "IVAN OIL"
Sh.a., së bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. 9284 Regj. Them., datë 15.03.2022, të Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili vendosi:

"1. Pranimin e kërkesës.

2. Lëshimin e urdherit të ekzekutimit për vënien në ekzekutim të
detyrueshëm të detyrimit në total në shumën 1,451.502,2 (një milion e
katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e dy presje dy) lekë, që ka
debitori shoqëria tregtare "REMI TRANS" SHPK, me NIPT L61308061D,
kundrejt palës kërkuese kreditore, shoqërisë "IVAN OIL" SHA, që
pasqyrohet në faturën tatimore të shitjes nr.651, datë 14.02.2020, me nr.
serie 80185651.

3. Ngarkohen shërbimet përmbarimore gjyqësore, shtetërore ose private
për zbatimin e këtij urdhri ekzekutimi.


4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës debitore.

5. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje dhe si i tillë ka vlerë.

6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim

7. U shpall sot në Tiranë, më 15.03.2022."

Pas marrjes dijani të debitorëve, si dhe kalimit të afatit 10 (dhjetë) ditor të
Lajmërimit për Ekzekutim Vullnetar, datë 22.06.2022, për ekzekutimin e Urdhrit të



Ekzekutimit të sipërpërmendur, duhet të kryhen bllokimet e menjëhershme të aksioneve/kuotave apo interesave të tjera të **debitorit**:

- Shoqërisë **"REMI TRANS"** Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**.

Për sa më sipër, në zbatim të neneve **527**, e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit Nr. **26/2019**, datë 08.05.2019 "**Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat**", dhe Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë",

URDHËROJ:

1. Vendosjen e menjëhershme të masës së sekuestros konservative në kuotat e shoqërisë **"REMI TRANS"** Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**; dhe moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar; dhe
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore shoqëria **"REMI TRANS"** Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi** në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.
4. *Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.*
5. Ky Urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve.

Zyra Përmbartimore Private ARB
Përmbartuesi Gjyqësor Privat



Bashkangjitur do të gjeni:

- Urdhri i ekzekutimit Nr. **9284** Regj. Them., datë **15.03.2022**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe
- Fatura tatimore e shitjes Nr. **651**, datë **14.02.2020**; dhe
- Lajmërim për Ekzekutim Vullnetar Nr. **1/727** Prot., datë **22.06.2022**, Dosja Nr. **727**, firmosur nga debitori.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË
DHOMA CIVILE

Nr. Regj.Them 9284

Data e regjistrimit 02.02.2022

Data e vendimit 15.03.2022

VENDIM
Në emër të Republikës

“Për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në dhomë këshillimi”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

Anila KARANXHA - Gjyqtare

në cilësinë e gjyqtares së vetme, sot më datë 15.03.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, çështjen civile nr.9284 që i përket:

- Kërkues:** Shoqëria “IVAN OIL” SHA, me NIPT L81920001S, përfaqësuar nga administratori z. Eqerem Hoxha, me adresë të ushtrimit të aktivitetit: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla Nr.1, kati 13, Tiranë.
- Objekti:** Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv faturën tatimore të shitjes: nr. i faturës 651, datë 14.02.2020, me nr.serial 80185651.
- Debitor:** Shoqëria “REMI TRANS” SHPK, me NIPT L61308061D, me administrator Ardit Palushi, me adresë të zyrës qendrore: Njësia Bashkiake Nr.7, Rr. “Dritan Hoxha”, pallati “Karavan”, Hyrja 3, ap.26, Laprakë, Tiranë.
- Baza ligjore:** Nenet 510, 511 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenet 4, 5, 6, 11, 12, 16 të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore” dhe ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

☛ Gjykata, pasi u njoh me kërkesën dhe aktet bashkëngjitur saj,

VËREN:

Kërkuesi, shoqëria "IVAN OIL" SHA ushtron veprimtari tregtare në fushën e tregtimit të hidrokarbureve etj. Kërkuesi i ka kryer furnizime të herë pas herëshme shoqërisë "REMI TRANS". Për këtë shërbim, Kërkuesi ka lëshuar faturën tatimore të shitjes nr.651, datë 14.02.2020, me nr. serie 80185651. Shërbimi i ofruar sipas faturës ka vlerën 1.451.502,2 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e dy presje dy) lekë.

Fatura tatimore objekt kërkesë rezulton të jetë nënshkruar rregullisht nga palët. Kërkuesi e ka deklaruar faturën tatimore objekt kërkitimi në librin e shitjeve të muajit Shkurt 2020, pjesë e dosjes gjyqësore. Kërkuesi e provon faktin e shërbimit dhe faturimit të shërbimit, përmes kartelës së llogarisë që ka mbajtur për këtë rast, për klientin REMI TRANS ku gjen pasqyrim rregullisht fatura tatimore e shitjes nr.651/14.02.2020.

Kërkuesi pretendon se fatura tatimore e shitjes duhet të paguhej nga blerësi, shoqëria "REMI TRANS" SHPK brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i faturës për shërbimin e realizuar. Kjo gjë, sipas saj, nuk ka ndodhur. Sipas kërkueses, shërbimi i lëvruar nga ajo është pranuar pa pretendime apo kundërshtime nga pala debitore.

Pala kërkuese pretendon se shoqëria "REMI TRANS" SHPK, nuk e ka shlyer detyrimin që buron nga fatura tatimore objekt kërkitimi në favor të palës kreditore deri në ditën e paraqitjes së kësaj kërkesë, me gjithë përpjekjet e bëra për pagimin e detyrimit jashtëgjyqësisht. Duke qenë se edhe pas kalimit të afatit ligjor nga lëshimi i faturës, pala debitore nuk e ka shlyer detyrimin, Kërkuesi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për detyrimin monetar të parashikuar në faturën tatimore të shitjes objekt gjykimi.

Bazuar në nenet 36, 41, 49 dhe 511 të K.Pr.Civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka juridiksion, kompetencë lëndore e tokësore për lëshimin e urdhrin ekzekutiv.

Në lidhje me kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit gjykata konstaton se:

Shoqëritë tregtare "IVAN OIL" SHA dhe "REMI TRANS" SHPK, janë shoqëri të krijuara sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar (të dhënat e ekstraktit historik të tyre pranë QKB-së i bashkëngjiteshin kërkesës). Veprimet juridike që kryejnë këto shoqëri, përbëjnë "sipërmarrje tregtare", në kuptim të nenit 3, pika 3 të ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare". Sipas

përkufizimeve të përcaktuara në këtë ligj "Veprimi juridik tregtar" është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare nga njëra anë, dhe autoriteteve publike, nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese.

Detyrimi monetar i parashikuar në faturën tatimore objekt gjykimi, në kuptim të nenit 16 të ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", do të përbëjë titull ekzekutiv vetëm nëse detyrimi ka lindur nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil. Këto detyrime përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e shumës mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, çka nënkupton lëshimin e një urdhri ekzekutivi nga Gjykata. Ligjvënësi këtë të drejtë ia ka lënë pikërisht gjykatës, pasi organi ekzekutiv (përbaruesi gjyqësor) duhet të lirohet nga domosdoshmëria për të hetuar, nëse ai që kërkon ekzekutimin e titullit ekzekutiv është apo jo titullar i së drejtës e cila ka mbetur e papërbushur.

Nga ana tjetër K.Pr.Civile në nenin 510/e parashikon: "Janë tituj ekzekutivë aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre". Sa më sipër, në zbatim të nenit 510 të K.Pr.Civile, titulli ekzekutiv është vetëm akti, forma e materializuar e mbajtjes së detyrimit (vendim gjyqësor, arbitrazhi, fatura tatimore e shitjes së energjise elektrike, akt për dhenien e kredive nga institucionet financiare jobankare, akt për dhenien e kredive bankare...etj) dhe jo vetë detyrimi i përcaktuar në këto akte. Në ndryshim nga ky parashikim i K.Pr.Civile, ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", konsideron titull ekzekutiv që ekzekutohet nga përbarimi sipas dispozitave të K.Pr.Civile, vetë detyrimin që lind nga një veprim juridik tregtar.

Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim ka vend për pranimin e kërkesës së palës kërkuese. Urdhëri i ekzekutimit duhet lëshuar për faturën tatimore të shitjes nr.651, datë 14.02.2020 me nr.serie 80185651, për detyrimin në total më shumë 1,451.502,2 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e dy presje dy) lekë. Gjykata vlerëson se për këtë faturë detyrimi është i saktë dhe i qartë, detyrimi që përmban kjo faturë është pranuar dhe nga debitori, pasi tek rubrika blerësi ndodhet nënshkrimi i kësaj pale. Pala kërkuese e ka pasqyruar përmbajtjen e faturës tatimore në dokumentet përkatës kontabël: librin e shitjeve dhe kartelës së llogarive.

Detyrimi i përcaktuar në faturën tatimore të shitjes të mësipërme konstatohet se:

- Ka lindur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” (neni 15 i ligjit);
- Është i përcaktuar saktë;
- I kërkueshëm, pasi edhe pas kalimit të afatit (neni 463 i K.Civil), detyrimi i përcaktuar në fatura nuk rezulton të jetë përmbushur;
- I njohur prej të dy palëve të veprimit juridik tregtar.

Bazuar në analizën ligjore dhe faktike të mësipërme, gjykata çmon se detyrimi që përmban fatura tatimore e shitjes nr.651/14.02.2020 e lëshuara nga pala kërkuese shoqëria “IVAN OIL” SHA, për blerësin shoqërinë tregtare “REMI TRANS” SHPK, përbën titull ekzekutiv dhe kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për këtë faturë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenet 510, 511 të K.Pr.Civile,

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të detyrimit në total në shumën 1,451.502,2 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e dy presje dy) lekë, që ka debitori shoqëria tregtare “REMI TRANS” SHPK, me NIPT L61308061D, kundrejt palës kërkuese kreditore, shoqërisë “IVAN OIL” SHA, që pasqyrohet në faturën tatimore të shitjes nr.651, datë 14.02.2020, me nr. serie 80185651.
3. Ngarkohen shërbimet përbarimore gjyqësore, shtetërore ose private për zbatimin e këtij urdhri ekzekutimi.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës debitore.
5. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje dhe si i tillë ka vlerë.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.
7. U shpall sot në Tiranë, më 15.03.2022.

GJYQTARE

Anila KARANXHA

PULLE TARIFE

Anila Karanxha

Shpenzime gjyqësore

Tarifë gjyqësore	200	lekë
TOTALI	200	lekë



Nr. i Serisë: 30185851 FATURË TATIMORE SHITJE

EMRI I SHITËSIT: IVAN OLL

Data: 14, 02, 2020

ADRESA: P.0520 ROMANO-BURDZH

Nr. i Fatursës: 651

TELEFONI:
NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)

2819200015

EMRI I BLERËSIT: REMI TRANS
ADRESA: UOPE
TELEFONI:

2613080610

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)


EMRI I TRANSPORTUESIT: AZ DISTRIBUTION
ADRESA: TITAN

232204031E

TARGA E MJETIT: AA 546 NJ
ORA E FURNIZIMIT: 14.02

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)

Nr	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefte pa TVSH	Vlefte e TVSH	Vlefte mat TVSH
2	DIESEL	litra	10045	120	120981	24191	1451502
	165 33 132						
	133						
	134						
	135						
	136						
	MOSTRA 165 33 131						
TOTALI					120981 24191 1451502		



Nga të cilat: Furnizime të tatueshme
Furnizime të patatueshme

- a) faqe 1: Originali - Blerësi.
- b) faqe 2: Transportuesi
- c) faqe 3: Shitësi.

BLERËSI (emër, mbiemër, nënshkrimi): *Arbër Pekushi*

TRANSPORTUESI (emër, mbiemër, nënshkrimi): *Coler Vano*



R.1.V.0558

REPUBLIK
ALBANI
PERMBARUES



Datë: e mërkurë, 2022-06-22
Ora 10:28
Nr. 1/727 Prot.
Dosja Nr. 727

**LAJMËRIM
PËR EKZEKUTIM VULLNETAR**

Drejtuar Debitorit: Shoqërisë "REMI TRANS" Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**;

Për dijeni Kreditorit: Shoqëria "IVAN OIL" Sh.a., shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT **L81920001S** dhe adresë në: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr. 1, Kati 13, Tiranë, përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor **Z. Eqerem Hoxhaj**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë zyrës përmbarimore private ARB pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. 727, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit Nr. 9284 Regj. Them., datë 15.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se më datë 17.06.2022 është depozituar pranë ARB kërkesa e kreditorit "IVAN OIL" Sh.a., së bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. 9284 Regj. Them., datë 15.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili vendosi:

"1. Pranimin e kërkesës.

2. Lëshimin e urdherit të ekzekutimit për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të detyrimit në total në shumën 1,451.502,2 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e dy presje dy) lekë, që ka debitori shoqëria tregtare "REMI TRANS" SHPK, me NIPT L61308061D, kundrejt palës kërkuese kreditore, shoqërisë "IVAN OIL" SHA, që pasqyrohet në faturën tatimore të shitjes nr.651, datë 14.02.2020, me nr. serie 80185651.

3. Ngarkohen shërbimet përmbarimore gjyqësore, shtetërore ose private për zbatimin e këtij urdhri ekzekutimi.

4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës debitore.

5. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje dhe si i tillë ka vlerë.

6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim

7. U shpall sot në Tiranë, më 15.03.2022."

Sa më sipër, në mbështetje të neneve 517, 518, 525 të Kodit të Procedurës Civile,

LAJMËROJ:

1. Debitorin shoqëria "REMI TRANS" Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**, të bëjë ekzekutimin vullnetar brenda **10 (dhjetë)** ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit ndaj palës kreditore "IVAN OIL" Sh.a., duke



vepruar sipas Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 9284 Regj. Them., datë 15.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa më sipër, bazuar në Vendimin sipërcituar, debitori, shoqëria "REMI TRANS" Sh.p.k, me NIPT L61308061D, i detyrohet kreditorit, shoqërisë "IVAN OIL" Sh.a., me NIPT L81920001S shumat prej:

i. 1,451,702.20 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dy pikë dy) lekë (që përfaqëson detyrimin kryesor dhe shpenzimet gjyqësore); detyrimisht të kalohet në Numrin e Llogarisë Qëllimore, IBAN: AL40 2101 1029 0000 0000 0251 3803 në ALL (Lekë) të Alban Ruli pranë ABI Bank (sipas Ligjit 26/2019 "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", neni 42, pika 1); dhe

ii. Tarifën përmbartimore 174,180.00 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë (përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar) që përfaqëson tarifën fikse, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet përmbartimore e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat" i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, Seksioni III/2); detyrimisht të kalohet në Numrin e Llogarisë Joqëllimore, IBAN: AL71 2101 1287 0000 0000 0204 9109 në ALL (Lekë) të ARB pranë ABI Bank (sipas Ligjit 26/2029 "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", neni 42, pika 2);

- Në total detyroheni të paguani shumën neto prej 1,625,882.2 (një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy pikë dy) lekë detyrimisht të kalohet sipas urdhërimeve të sipërcituara; çdo kosto lidhur me shumën/at e kaluar/a do t'i llogaritet/n debitorit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbartuesi gjyqësor. (shih nenin 517 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile).

3. Nëse ekzekutimi vullnetar nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit, ndaj palës debitore zyra e përmbartimit privat ARB do të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm.

4. Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.

Zyra e Përmbartimit Privat ARB
Përmbartuesi Gjyqësor Privat



Bashkangjitur do të gjeni:

- Urdhri i ekzekutimit Nr. 9284 Regj. Them., datë 15.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe
- Fatura tatimore e shitjes Nr. 651, datë 14.02.2020.

1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT

Objekti.....1/777.....Nr.....datë.....22.06.2022.....
Është pranuar në zyrën.....në drejtim të zotit
Shërbimi "EMI TRANS" sh.p.ç
Laprahe, Tiranë

2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është.....
Dorëzuar me datën.....23/06/22
Paguar
Emri mbiemri i shpërndarësit
Emri mbiemri i marrësit të objektit
SHËNIME TË VEÇANTA
Vula datare e Zyrës
Dorëzuese të objektit





POSTA SHQIPTARE sh.a.



RR 044 706 097 AA

34



14

Vula e Zyrës Pranuese të Lajmërimit

RJE NR.....

Ky lajmerim - marrje do te kthehet
ne adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

Mod P6

Zyra, Permbardhëse ARB
Rr. Shinas, Dishni ca
Rr. 70, Kati 2, Zyra 2,
Tirane



Datë: e martë, 2022-07-05
Ora 14:22
Nr. 5726 Prot.
Dosja Nr. 726

**URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

- Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit, me adresë në:
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e
Ushtarakëve, Tiranë;
- Për dijëni Debitorit:** Shoqërisë "REMI TRANS" Sh.p.k., me NIPT L61308061D,
dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan,
Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues
Ligjor **Z. Ardit Palushi**;
- Për dijëni Kreditorit:** Shoqëria "EROIL" Sh.a., shoqëri tregtare e regjistruar
pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT
L32230076S dhe adresë në: Rruga "Donika Kastrioti",
Pallati Nr. 8, Kati 3, Apartamenti Nr. 2/4, Tiranë,
përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor **Z. Olsi Derhemi**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë zyrës përmbarrimore private ARB pasi studiova materialet e dosjes përmbarrimore Nr. 726, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit Nr. 8282 Regj. Them., datë 20.04.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se më datë 17.06.2022 është depozituar pranë ARB kërkesa e kreditorit "EROIL" Sh.a., së bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. 8282 Regj. Them., datë 20.04.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili vendosi:

"1. Pranimin e kërkesës.

2. Lëshimin e urdherit të ekzekutimit për Faturën Tatimore të Shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt 15.07.2020, lëshuar nga ana e Kreditorit: Shoqëria "EROIL" sh.p.k., me seli në Tiranë, Rr. "Donika Kastrioti", Pall. Nr. 8, Kati 3, Ap. Nr. 2/4, me përfaqësues me autorizim Zj. Dalina Hoxha, me NIPT L32230076S që shprehin detyrimin e Debitorit: Shoqëria "Remi Trans" sh.p.k., me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 7, Rr. "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, H. 3, AP. 26, Laprakë, me NIPT L61308061D, në shumën prej 1,966,569 (një milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e nente) lek, si dhe mbi këtë detyrim të perlllogariten nga përmbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit, kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

3. Ngarkohen Shërbimi Përmbarrimore të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

4. Ky vendim hartohet vetëm në një kopje

5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet të bëhet ankim.

7. U shpall sot më 20.04.2022 në Tiranë."



QENDRA KOMBETARE
E BIZNESIT
Nr. _____
Prift _____
Data _____

A
PERBARUES G.
REPI

Pas marrjes dijani të debitorëve, si dhe kalimit të afatit 10 (dhjetë) ditor të Lajmërimit për Ekzekutim Vullnetar, datë 22.06.2022, për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit të sipërpërmendur, duhet të kryhen bllokimet e menjëhershme të aksioneve/kuotave apo interesave të tjera të **debitorit**:

- Shoqërisë **"REMI TRANS"** Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**.


Për sa më sipër, në zbatim të neneve **527**, e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit Nr. **26/2019**, datë 08.05.2019 "**Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat**", dhe Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë",

URDHËROJ:

1. Vendosjen e menjëhershme të masës së sekuestros konservative në kuotat e shoqërisë **"REMI TRANS"** Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**; dhe moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar; dhe
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore shoqëria **"REMI TRANS"** Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi** në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.
4. *Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.*
5. Ky Urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve.

Zyra Përmbartimore Private ARB
Përmbartuesi Gjyqësor Privat

Alban Ruli



Bashkangjitur do të gjeni:

- Urdhri i ekzekutimit Nr. **8282** Regj. Them., datë **20.04.2022**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe
- Fatura tatimore e shitjes Nr. **147**, datë **15.07.2020**; dhe
- Lajmërim për Ekzekutim Vullnetar Nr. **1/726** Prot., datë **22.06.2022**, Dosja Nr. **726**, firmosur nga debitori.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr: 9282 REGJ. THEMELTAR

V E N D I M
“PËR LESHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretarja gjyqësore Besa Lleshi, sot më datë 20.04.2022 mori në shqyrtim në dhomë keshillimi, çështjen civile me Nr. 9282 Regj. Themeltar, që i përket :

KERKUES : Shoqëria “EROIL” sh.p.k, me seli ne Tirane, Rr. “Donika Kastrioti”, Pall. Nr. 8, Kati 3, Ap. Nr. 2/4, me NIPT L32230076S.

OBJEKTI : Leshimi i Urdherit te Ekzekutimit për Faturen Tatimore te Shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020 ne shumen 1,966,569 lek, te leshuar kundrejt shoqërise “Remi Trans” sh.p.k.

BAZA LIGJORE : Neni 510 e vijues i Kodit të Procedurës Civile, Ligji Nr. 48/2014 “Per pagesat e vomuara ne detyrimet kontraktore tregtare”.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN :

Se, kërkuesi shoqëria «EROIL» sh.p.k., ka paraqitur për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020 ne vleren e pashlyer te saj ne shumen 1,966,569 lek, te leshuar kundrejt shoqërise “Remi Trans” sh.p.k .

Nga administrimi i akteve rezultoi e provuar se :

Se, pala kërkuese shoqëria “EROIL” sh.p.k. eshte subjekt i se drejtes tregtare e regjistruar si person juridik që prej datës 30.10.2013, me objekt të veprimtarisë së saj tregtare në fushën e tregtimit të hidrokarbureve.

Në zbatim të veprimtarisë së saj tregtare shoqëria “EROIL” sh.p.k. rezulton të ketë hyrë në një marrëdhënie kontraktore shitje/furnizimi, me shoqërinë “Remi Trans” sh.p.k.

Keshtu, fakti i sipërcituar provohet nga faturat tatimore te shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020 ne vleren e pashlyer te saj ne shumen 1,966,569 lek, te leshuar kundrejt shoqerise "Remi Trans" sh.p.k .

Sipas pretendimeve të shprehura ne kerkese nga ana e shoqërisë "EROIL" sh.p.k. nuk rezulton që të jetë përmbushur detyrimi për pagimin e çmimit të përcaktuar në faturen tatimore të shitjes të sipërcituar edhe pas njoftimeve verbale e formale te kryera ndaj saj. Për këtë shkak lidhur me këte fature tatimore në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", sipas pales kerkuese, duhet të lëshohet urdhëri i ekzekutimit nga ana e gjykates.

Cilësinë e titullit ekzekutiv, në kuptim të dispozitave proceduriale mbi ekzekutimin e detyrueshëm e kanë vetëm aktet e përcaktuara sipas Nenit 510 të K. Pr. Civile. Në nenin 510 gërma "e" të K. Pr. Civile parashikohet shprehimisht se konsiderohen tituj ekzekutivë të gjitha aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet Zyra e Përmbartimit për ekzekutimin e tyre.

Ligji nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", në nenin 16 të tij parashikon se:

"1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile."

Në rastin konkret në zbatim të dispozitave të sipërcituara rezulton që të plotësohen kushtet për ta konsideruar faturen tatimore të shitjes Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020 ne vleren e pashlyer te saj ne shumen 1,966,569 lek, te leshuar kundrejt shoqerise "Remi Trans" sh.p.k , për mallin e ofruar asaj, për arsye se:

Pala kerkuese shoqëria "EROIL" sh.p.k. rezulton ta ketë ofruar sherbimin e saj me shitjen e mallit te kerkuar ndaj shoqërisë "Remi Trans" sh.p.k. dhe kjo e fundit nuk rezulton që të ketë kundërshtuar shërbimet e ofruara nga ana e shoqërisë "EROIL" sh.p.k. perkundrazi me ane te nenshkrimit te saj, ka njohur dhe pranuar ne teresi elementet e kesaj fature persa i perket permbajtjes se saj ne sasi, vlere per sherbimin e ofruar. Në kështu, sipas librit te shitjes se pales kerkuese te paraqitur si prove ne gjykim, rezulton se kjo fature tatimore eshte deklaruar si e tille prane organeve tatimore.

Nuk rezulton që të jemi në kushtet e përcaktimeve të nenit 485 të K. Civil.

Në kuptim të përcaktimeve të nenit 16 të ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", fatura tatimore e shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020 ne vleren e pashlyer te saj ne shumen 1,966,569 lek, te leshuar kundrejt shoqerise "Remi Trans" sh.p.k, për mallin e ofruar asaj rezulton që të konsiderohet titull ekzekutiv, për zbatimin e të cilit ngarkohet shërbimi përmbartimor.

Gjykata arriti në këtë përfundim pasi analizoi faktin dhe në bazë të nenit të sipërpërmendur kjo fature përbën titull ekzekutiv.

Po keshtu Neni 511 i K. Pr. Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 114/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", percakton se: "Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi.

Urdhri i ekzekutimit përmban:

a) gjenealitetet e debitorit dhe kreditorit;

b) origjinën e detyrimit;

c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit;

d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare,

Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.”

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, gjykata vendos të pranojë kërkesën si të bazuar në ligj dhe në prova dhe të lëshojë urdhrin e ekzekutimit për faturen tatimore të shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020 në vlerën e pashlyer të saj në shumën 1,966,569 lek, të lëshuar kundrejt shoqërisë “Remi Trans” sh.p.k, për mallin e ofruar.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata bazuar në Nenin 306 e vijues, 510 gërma “e” dhe 511 gërma “ç” të K. Pr. Civile, si dhe në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”,

VENDOSI :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për Faturen Tatimore të Shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt. 15.07.2020, të lëshuar nga ana e

Kreditorit: Shoqëria “EROIL” sh.p.k., me seli në Tiranë, Rr. “Donika Kastrioti”, Pall. Nr. 8, Kati 3, Ap. Nr. 2/4, me perfaqësues me autorizim Zj. Dalina Hoxha, me NIPT L32230076S,

që shprehin detyrimin e,

Debitorit: Shoqëria “Remi Trans” sh.p.k, me seli në Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 7, Rr. “Dritan Hoxha”, Pallati Karavan, H. 3, AP. 26, Laprake, me NIPT L61308061D,

në shumën prej 1,966,569 (një milion e nentëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtedhjetë e nente) lek, si dhe mbi këtë detyrim të perlogariten nga permbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit, kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

3. Ngarkohet Sherbimi Permbarimor të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
4. Ky vendim hartohet vetëm në një kopje.
5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet të bëhet ankim.
7. U shpall sot më datë 20.04.2022 në Tiranë.

SEKRETARE

BESA LLESHI

GJYQTAR

ERVIN POLLOZHANI

Shpenzime gjyqësore
Takse mbi aktet
Totali

200 lek
200 lek



REP. A
PERBARUES GJ.

REPUBLIC OF INDONESIA
PERATURAN PEMERINTAH REPUBLIK INDONESIA
TENTANG
PERUBAHAN PERATURAN PEMERINTAH REPUBLIK INDONESIA
NOMOR 10 TAHUN 2019
TENTANG
PERUBAHAN PERATURAN PEMERINTAH REPUBLIK INDONESIA
NOMOR 10 TAHUN 2019
TENTANG
PERUBAHAN PERATURAN PEMERINTAH REPUBLIK INDONESIA
NOMOR 10 TAHUN 2019

Datë: e mërkurë, 2022-06-22

Ora 10:15
Nr. 1/726 Prot.
Dosja Nr. 726

**LAJMËRIM
PËR EKZEKUTIM VULLNETAR**

Drejtuar Debitorit: Shoqërisë **"REMI TRANS" Sh.p.k.**, me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**;

Për dijëni Kreditorit: Shoqëria **"EROIL" Sh.a.**, shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT **L32230076S** dhe adresë në: Rruga "Donika Kastrioti", Pallati Nr. 8, Kati 3, Apartamenti Nr. 2/4, Tiranë, përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor **Z. Olsi Derhemi**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë zyrës përmbarimore private **ARB** pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. **726**, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit Nr. **8282** Regj. Them., datë **20.04.2022**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se më datë 17.06.2022 është depozituar pranë **ARB** kërkesa e kreditorit **"EROIL" Sh.a.**, së bashku me:

1. Urdhrin e Ekzekutimit Nr. **8282** Regj. Them., datë **20.04.2022**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili vendosi:

"1. Pranimin e kërkesës.

2. Lëshimin e urdherit të ekzekutimit për Faturën Tatimore të Shitjes me Nr. Serial 90437147, Nr. Fat. 147, dt 15.07.2020, lëshuar nga ana e Kreditorit: Shoqëria "EROIL" sh.p.k., me seli në Tiranë, Rr. "Donika Kastrioti", Pall. Nr. 8, Kati 3, Ap. Nr. 2/4, me përfaqësues me autorizim Zj. Dalina Hoxha, me NIPT L32230076S që shprehin detyrimin e Debitorit: Shoqëria "Remi Trans" sh.p.k., me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 7, Rr. "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, H. 3, AP. 26, Laprakë, me NIPT L61308061D, në shumën prej 1,966,569 (një milion e nentëqind e gjashtedhjetë mijë e pesëqind e nente) lek, si dhe mbi këtë detyrim të perlllogariten nga përmbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit, kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

3. Ngarkohen Shërbimi Përmbarimore të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.


4. Ky vendim hartohet vetëm në një kopje

5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet të bëhet ankim.

7. U shpall sot më 20.04.2022 në Tiranë."

Sa më sipër, në mbështetje të neneve **517, 518, 525** të Kodit të Procedurës Civile,



LAJMËROJ:

1. Debitorin shoqëria "REMI TRANS" Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, dhe adresë në: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Karavan, Hyrja 3, Apartamenti 26, Laprakë, Tiranë; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Palushi**, të bëjë ekzekutimin vullnetar brenda **10 (dhjetë)** ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit ndaj palës kreditore "EROIL" Sh.a., duke vepruar sipas Urdhrit të Ekzekutimit Nr. **8282** Regj. Them., datë **20.04.2022**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa më sipër, bazuar në Vendimin sipërcituar, debitori, shoqëria "REMI TRANS" Sh.p.k., me NIPT **L61308061D**, i detyrohet kreditorit, shoqërisë "EROIL" Sh.a., me NIPT **L32230076S** shumat prej:

i. **1,861,714.00 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e katërbëdhjetë) lekë** (që përfaqëson detyrimin kryesor); detyrimisht të kalohet në Numrin e Llogarisë Qëllimore, IBAN: **AL40 2101 1029 0000 0000 0251 3803** në ALL (Lekë) të Alban Ruli pranë ABI Bank (sipas Ligjit 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", neni 42, pika 1); dhe

ii. Tarifën përmbarimore **223,405.00 (dyqind e njëzet e tre mijë e katërqind e pesë) lekë** (përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar) që përfaqëson tarifën fikse, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet përmbarimore e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat" i Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave, Seksioni III/2); detyrimisht të kalohet në Numrin e Llogarisë Joqëllimore, IBAN: **AL71 2101 1287 0000 0000 0204 9109** në ALL (Lekë) të ARB pranë ABI Bank (sipas Ligjit 26/2029 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", neni 42, pika 2);

- Në total detyroheni të paguani shumën **neto** prej **2,085,119.00 (dy milion e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë** detyrimisht të kalohet sipas urdhërimeve të sipërcituara; çdo kosto lidhur me shumën/at e kaluar/a do t'i llogaritet/n debitorit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor. (shih nenin 517 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile).

3. Nëse ekzekutimi vullnetar nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit, ndaj palës debitore zyra e përmbarimit privat ARB do të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm.

4. Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.

Zyra e Përmbarimit Privat ARB
Përmbaruesi Gjyqësor Privat



Boshkangjitur do të gjeni:

- Urdhri i ekzekutimit Nr. **8282** Regj. Them., datë **20.04.2022**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe
- Fatura tatimore e shitjes Nr. **147**, datë **15.07.2020**.

1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT

Objekti.....1/726.....Nr.....datë.....22.06.2022.....
Është pranuar në zyrën.....në drejtim të zotit
Shopëria "REMITRANS" sh.p.k.
Laprahe, Tirdane

2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT


Objekti i sipërtreguar është.....
Dorëzuar më datën.....23/06/22
Paguara
Emri mbiemri i shpërndarësit
Emri mbiemri i marrësit të objektit
SHËNIME TË VEÇANTA
Vula datore e Zyrës Dorëzuese të objektit





POSTA SHQIPTARE sh.a.
Zyra Postare

32



Vula e Zyrës Pranuese të Lajmërimit

LAJMËRIM MARRJE NR.....



Ky lajmerim - marrje do te kthehet
ne adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga uejsh...
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

Mod P6

Zyra Permbledhojese ARB
Rr. Shinas, Dëshnica
Rr. 70, kati 2, Zyra 2,
Tiranë

